



Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.IX
Deçan,dt.27.10.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IX-të të rregullt të KPF-së, me dt.27.10.2023.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj), drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, Enver cacaj- zyrtar për prezentim të pikës nr.2, 3 dhe 4 të rendit të ditës dhe Zyrtarja për informim, Edona Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Planit të Integritetit;
3. Shqyrtimi i Planit për barazi gjinore;
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të transportit rrugor lokal për Komunën e Deçanit 2023-2028;
5. Shqyrtimi i Raportit nëntë mujor financiar,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e nëntë të rregullt të KPF-së për vitin 2023, konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 6 anëtarë të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj) dhe ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes pastaj e prezantoi rendin e punës, i cili miratohet njëzëri, në të ndryshme të debatohet lidhur me zonat e rrezikuara nga vërshimet.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet procesverbali njëzëri pa vërejtje.

II.Shqyrtimi i Planit të Integritetit.

Enver Cacaj-Sqaron rreth planit të integritetit, për Qëllimin e Planit-vlerësimi i rreziqeve, ai ka thënë se raportohet çdo vit për fushat dhe të gjeturat eventuale.

Faton Selmanaj -pyet kush e ka artua dhe eka sjellë në KPF dhe Kuvend për shqyrtim, për të cilën pyetje Kryesuesi përgjigjet se Ajne Iberhysaj është hartuese e këtij plani mirëpo në mungesë të saj sqarimet i ep Enver Cacaj si bashkëhartues i planit me Ajne Iberhysaj.

Vatan Istrefaj-ka kërkuar sqarim, a ka kuti të ankesave, për të cilën përgjigjet Enver Cacaj, po thotë, ka kuti të ankesave.

Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, kryesuesi e qiti në votim, Kalon njëzëri në Kuvend për shqyrtim dhe miratim Plani i Integritetit.

III.Shqyrtimi i Planit për Barazi Gjinore.

Enver Cacaj ep sqarime.

Vatan Istrefaj, pyet-a janë qitë ndryshimet e propozuara gjatë periudhës së shqyrtimit të këtij dokumenti, (po përgjigjet Enveri).

Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, Kryesuesi e qiti në votim, antarët e KPF-së njëzëri e përcjellin në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

IV.Shqyrtimi i Draftë Planit për transport rrugor lokal për Komunën e Deçanit 2023-2028.

Enver Cacaj-në plan ende nuk janë të vendosura disa shënime në tregues të ndryshëm, mirëpo meqenëse është për leximin e parë edhe gjatë procedurës së shqyrtimit plotësohet me këto të dhëna.

Vatan Istrefaj- si draft nuk është i plotësuar sa duhet, si psh te numri i aksidenteve, ato me fatalitet dhe me dëme materiale dhe kërkon që të plotësohet me të gjitha të dhënat e nevojshme.

Enver Cacaj-priten raportet e sakta nga policia dhe me i vendos në dokument.

Faton Selmanaj- te siguria në komunikacion, pyet si te behet, te Synimet- ndërtimi i shtigjeve për çiklist dhe këmbësor gjate rrugëve, shprehet se me pëlqej kjo, te vend parkingjet (2800) mos është gabim, si dhe te transporti publik, teksti “jo kryesisht” duhet të zëvendësohet me fjalën “ tërësisht”.

Vatan Istrefaj-pyet a kanë të drejtë kombibusit me punu pa leje, dhe duhet me dalë në inspektim personi zyrtar kush i mbikëqyr ato, si dhe duhet të ishte shkruar dokumenti-si draft plan, jo Plan.

Enver Cacaj-do të specifikohen të gjitha pikat dhe do të vinë edhe zyrtaret përgjegjës me raportu në Kuvend ku do të ipen edhe sqarime shtesë.

Kryesuesi-me sygjerimet që u dhanë këtu po i hapim rrugë për shqyrtim në kuvend dhe debat publik, dhe është mirë që ky dokument ka ardhë si draft.

Njëzëri përcillet në Kuvend.

V. Shqyrtimi i raportit nëntë mujor financiar.

Faton Selmanaj- ka thënë se keq menaxhimi dhe keq planifikimi po vazhdon. Po vazhdon i njëjti transaksion te subvencionet, ku bëhet bartja prej një individi tek tjetri, gjë që nuk lejohet, psh. Sanije Thaqi –ka marrë subvencion për dike tjetër.

Dafina Cacaj-vëreja ka vlejte vetëm për ne punëtorët e administratës, që mos të jemi ne ata që bëjnë transaksion të subvencioneve për personin e tretë.

Faton Selmanaj- kërkon sqarim për pagesën e OJQ- Klubi i bjeshkatarëve, për të cilën drejtoresha, Dafina, përgjigjet se kjo është bërë me thirrje publike, dhe të gjitha OJQ-të janë përfitues sipas Thirrjes publike që është bërë, e cila ka qenë e publikuar. Edhe shpenzimi i buxhetit përmes përmbaruesit hiq nuk po nalet thotë Fatoni.

Drejtoresha, Dafina-Arsimi po na qon në përmbarim kryesisht.

Faton Selmanaj- thotë se pagesa për Mehmet Osaj paguhet bëhet më shumë se në një drejtori dhe shka përfaqëson ai.

Dafina –sqaron, se paguhet nga buxheti i asaj drejtorie ku ka buxhet të mjaftueshëm

Faton Selmanaj- ka vërejtje edhe te furnizimet për zyre duke thënë se janë shumë.

Vatan Istrefaj-kërkon sqarim për pagesën prej 3.500,00 € -dreka.

Drejtoresha- sqaron se në këto raste shumë fatura i bëjmë bashkë me specifikacion, shumë pagesa bashk bëhen dhe paguhen me një pagesë.

Vatan Istrefaj- ka vërejtje te shpenzimi-furnizim me material higjienik,shpenzime marramendëse, e ndërsa kurrë shampun e letër nuk ka në banjo.

Florim Mataj—thotë se në vazhdimësi kam tentu që shpenzimet të ulen-e të jetë arsyshmeria me fatura për çdo shpenzim, çdo shpenzim t’u epni justifikimet.

Yllarta Thaqi – edhe herën e kaluar kam kërkuar që te faturat ti keni arsyetimet për çka është bërë shpenzimi, ndërsa për 90% të kontratave në vepër ka ulje.

Drejtoresha, Dafina-thotë se jemi e vetmja komunë që e bënë raportin kaq detal, ndërsa te drekat— janë bërë shumë fatura bashkë, me një pagesë.

Kryesuesi- kemi shumë ngjarje dhe manifestime, aktivitete të ndryshme që i mbulon komuna, prandaj edhe ndodhin shpenzimet.

Florim Mataj-është mirë të ipet arsyesh mëria , sepse të gjithë pajtohen pastaj për shpenzime kur ta shohin arsyeshmërinë e tyre.

Yllarta Thaqi-të njëjtën gjë e thashë edhe unë sepse bohemi top lajm sa ju përket shpenzimeve.

Vatan Istrefaj-është mu bo top lajm, sepse kur i shohim 70.000,00€ dreka, atëherë folim pa arsyeshmëri.

Faton Selmanaj- ka cekë shpenzimin e dt.3 janar 2023 –Labinot Cacaj BI dhe kërkon sqarim-çfarë dreka dhe darka paguhet(886,00€), pastaj kërkon sqarim për pagesën përmbarimore –Mihane Dautaj-dy herë.

VI.Të ndryshme

Yllarta-e ngritë çështjen e shfuqizimit të Vendimit të Kryetarit për pezullimin e zbatimit të Rregullores komunale të dt.31.07.2019, për Caktimin e Orarit të Punës për Subjektet Afariste.

Kryesuesi-si KPF-me kërkua prej Inspektionit me na njoftu çka ka bo për zbatim të kësaj rregullore, si dhe të debatohet si pikë në kuvend, poashtu në kuvend të del si pikë dhe të debatohet për çështjen e kompenzimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet si dhe sanimi i gjendjes në lokacionet ku bëhen vërshimet.

Faton Selmanaj-Fekri Qufaj ka njoftu për çështjen e dhënies së pronave në shfrytëzim dhe ka pasë me hi si pikë në kuvend, njoftim detal i komisionit, kërkon sqarim pse nuk ka dalë si pikë.

Kryesuesi si KPF të rekomandojmë, që të debatohet në Kuvend:

-Çështja e shfuqizimit të Vendimit të Kryetarit dhe zbatimi i rregullores për orarin e lokaleve afariste, deri ku ka mbërri me shkua me këtë çështje sepse bizneset ende po punojnë edhe ditën e diele pa ndryshime.

-Njoftim nga Drejtoi i Sh.Publike për çështjen e kompenzimit të dëmeve nga vërshimet dhe sanimi i gjendjes në lokacionet ku bëhen vërshimet, me të cilin rekomandim pajtohen në KPF.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Llolluni



Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ



Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.X
Deçan,dt.27.11.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e X-të të rregullt të KPF-së, me dt.27.11.2023.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj), drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj dhe Zyrtarja për informim, Edona Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Propozim- Vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;
3. Shqyrtimi i Draft- Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë;
4. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2027;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e X-të të rregullt të KPF-së për vitin 2023, konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 6 anëtarë të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj) dhe ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes pastaj e prezantoi rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij.

Faton Selmanaj- Gjykata Kushtetuese e ka miratua vendimin në favor të faljes së borgjeve për tatim në pronë në shumën e njëhershme deri në 100 euro, meqenëse Gjykata e ka miratua , ai ka propozuar që me rekomandim të KPF-së, të hyn në rend dite në Kuvend pika, Falja e borgjeve në shumën deri 100 euro për tatim në pronë, që do të jete falje e njëhershme.

Florim Mataj- thotë pajtohem me propozimin e parafolësit , mirëpo e përkrahi këtë propozim vetëm nëse Ministria i rimbursion komunën për aq mjete sa bëhet falja e borgjit.

Drejtoresha , Dafina Cacaj ka sqaruar që komuna e Deçanit nuk ka pasur rritje të tatimit në pronë, për këtë arsye nuk mund ta përkrahë këtë propozim, sepse dëmtohem shumë si komunë.

Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e Faton Selmanaj, për ti rekomanduar kuvendit shqyrtimin e pikës Falja e borgjit të tatimit në pronë në shumën deri 100 euro, me 2 vota për dhe 4 kundër nuk kalon ky propozim.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi- e prezantoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pastaj e hapi debatin rreth tij.

Anëtarët e KPF-së kanë pasë vërejtje se procesverbali është shkruar në fjali shumë të shkurta ku si pasojë i ka humbë kuptimi diskutimit, në fund pas vërejtjeve , i njëjti miratohet njëzëri, mirëpo duhet të përpunohet edhe një herë procesverbali.

II. Shqyrtimi i Propozim- Vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.

Kryesuesi e ka prezentu pikën pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë Drejtoreshës, Dafina Cacaj, e cila ka sqaruar se propozimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024, ka ulje në krahasim me vitin e kaluar.

Faton Selmanaj- ka propozuar ulje prej 0.1% të dy pikat e para të propozimit (për njësitë bujqësore të parcelave dhe njësitë bujqësore të objekteve) dhe ajo përqindje ose të rritet të njësitë industriale ose ku do që e vlerësoni ju, sepse unë në ligj e kam parë se komunat kanë të drejtë prej 0.5 deri në 1% me bo lëvizje ose me ngrite ose me zvoglu normën (për të cilën drejtoresha tha se do ta konsulton ligjin dhe përgjigjen e ep në Kuvend).

